



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 401-33801 /2023

Klinë, datë 22/09/2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, dispozitat e nenit 19 të Rregullores së MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, më qellim të përmbushjes së këtyre obligimeve, Kryetari i Komunës së Klinës, **merr këtë;**

V E N D I M

*Për formimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare
në shkolla fillore dhe të mesme në Komunën e Klinës*

- FORMOHET**, komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare në shkolla fillore dhe të mesme në Komunën e Klinës, në këtë përbërje:
 - Astrit Muhaxheri**, kryesues;
 - Rexhep Sejdia**, anëtar;
 - Sami Bardheci**, anëtar.
- Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi është i obliguar që të bëjë inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Klinës dhe për punën e vetë përgatit raport për kryerjen e inventarizimit, të cilin raport ja paraqet Drejtorisë së Financave si dhe një kopje kryetarit të Komunës dhe atë më së largu deri në pjesën e parë të muajit dhjetor 2023.
- Komisioni punën e vetë e kryen në përputhje me dispozitat e Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Anëtarët e komisionit;
- Ekzekutivi- DFEZH si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

